



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:146220

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05448492

CP.nr.1025/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorëve B. F., te cilin me autorizim e përfaqëson avokat Gazmend Ismajli me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Ndërmarrja “T.” sh.a. me seli ne M. lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi Cnr. 1209/2020, te datës 31.05.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP 1025/22, te datës 01.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 13.03.2024 morri këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP. 1025/2021, e iniciuar nga kreditori B. F. ndaj debitorit Sh. a “T.”, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditorët e përmbartimit B. F., përmes te autorizuarit te tij avokat Gazmend Ismajli me seli ne Mitrovice, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi 1209/2020, te datës 31.05.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbartimit, me aktvendimin CP. 1025/2022, te datës 01.09.2021, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit Ndërmarrja “T.” Sh. a. –me seli ne M.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP. 1025/2022, te datës 01.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt.13.03.2024, ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbartimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbartim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbartimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë*

se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CP.nr.1025/2021 më datë 13.03.2024

Gjyqtari,
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.